REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

| Pranuar-Primljeno Me-Dana | 17-03-2026 | | |
|---|---|---|---|
| Nr. I organit Org. Broj | Numri Broj | | Vlera Vrednost |
| 01 | 060 | /01 | 344 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 53, të Ligjit Nr. 03/L - 040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 44, 45 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komiteti për Komunitete bënë këtë:

**F T E S Ë**

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-II-**, të rregullt të Komitetit për Komunitete, që do të mbahet me datë **25.03.2026** duke filluar në ora **10h.**

Mbledhja do të mbahet në sallen e konferencave të Komunës së Vitisë.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

**R e n d   d i t e**

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Komunitete**
2. **Diskutim për vendosjen e ngadalësuesve të trafikut (policëve të shtrirë) në fshatin Binçë.**
3. **Të ndryshme.**

Viti, 18.03.2026,
Me respekt,

Kryetari i Komitetit për Komunitete
z.Nenad Ilic
N. Ilić

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

# PROCESVERBAL
# NGA MBLEDHJA E PARË E RREGULLT E KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Është mbajtur mbledhja e I e rregullt e Komitetit për Komunitete të Komunës së Vitisë. Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi kryesuesi i Kuvendit, z.Bekim Azizi. Mbledhja është mbajtur në zyrën e kryesuesit te Kuvendit. Mbledhja është mbajtur me **26.02.2026** në orën **10h**. Në mbledhje ishin të pranishëm kryesuesi i kuvendit, z.Bekim Azizi, z.Nenad Ilic, znj.Kata Pala, znj.Sanja Dejic Vasic, z.Rifat Aniqi, znj.Djellza Fejzullahu. Gjithashtu kanë marrë pjesë përfaqësuesja e OSBE-së znj.Violeta Mehmeti dhe zyrtari për Komunitete dhe Kthim, z.Zoran Marinkovic, ndërsa munguan z.Visar Demiri, z.Elhami Emërllahu.

**z.Bekim Azizi, kryesuesi takimit:** Faleminderit shumë që keni gjet kohë t'i përgjigjeni ftesës për themelimin e Komitetit për Komunitete, i cili është komitet obligativ që formon Kuvendi Komunal në Viti. Unë, për ata që nuk më njohin, jam kryesuesi i Kuvendit Komunal në Viti. Unë nuk jam anëtar i komitetit, por sot ju kam ftu për me themelu komitetin, pasi që veç jam përgjegjës prej Kuvendit. Komitetin këtë mandat e kemi themelu prej 7 anëtarëve. Janë të përfshira komunitetet që jetojnë në komunën e Vitisë. Nga 7 anëtarë, 4 janë të komuniteteve dhe 3 janë nga komuniteti shumicë, kështu edhe e përcakton ligji. E përshëndes edhe përfaqësuesen e OSBE-së, e cila sot është këtu, e cila përherë i monitoron takimet. Edhe e përshëndes Zoranin që është nga Zyra e Komuniteteve. Fatlumi është sekretar i Kuvendit, i cili është pjesë e përhershme e takimeve të komuniteteve. Është lidhje mes komiteteve dhe kërkesave, rekomandimeve të juaja që vijnë në Kuvend; shkojnë përmes sekretarit që vijnë te na. Dy anëtarë i kemi edhe nga komiteti i kalum. Komiteti i kalum i ka pas 5 anëtarë. Kta janë kanë familjarizu dhe kanë pas një raport jashtëzakonisht të mirë. Besoj që edhe këtë mandat do të jeni mandat i mirë, edhe i lidhjeve, edhe i shoqërimit, edhe i ngritjes së interesave të qytetarëve për të cilët jeni edhe të përcaktum. Është komitet që punën e kryen me pagesë. Nëse mungoni nuk paguheni. Kur të jeni në seancë merrni mëditje. Mëditja është dikun 200 euro. Një takim në muaj e keni obligim me majt në bazë të ligjit. Prandaj, rendi i ditës për këtë takim, në bazë të ftesës që e keni marrë, është:

## Rendi i ditës

1. **Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete.**
2. **Të ndryshme.**

Pika e parë e rendit të ditës:

1. **Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Komunitete**

Planin e punës e kemi të miratuar në Kuvend, që e keni një lehtësim komiteti juaj, se e kemi miratu para vitit të ri me komitetin që ka qenë ekzistues më herët, e kemi miratu planin për sivjet. Prandaj, nëse ki Violetë mi përshëndet ose diçka:

**znj.Violeta Mehmeti, OSB-e:** Shkurtimisht, dmth, OSBE është prezent, i ka në mbikëqyrë dhe i monitoron mekanizmat që janë për pjesëmarrje të komuniteteve, që i bjen Komiteti për Komunitete, Zyra për Komunitete dhe

Kthim dhe mekanizma të tjerë. E dinë kush ka qenë më herët që ne jemi prezent dhe jemi aktiv, edhe kemi aktivitete të ndryshme. Kemi përkrahë dhe do të vazhdojmë ta përkrahim punën e komitetit, si në funksionim ashtu edhe në aktivitete, bashkëpunim me komuna tjera e kështu me radhë. OSB-e, me vite me radhë, është angazhu për me ju ofru trajnime për mekanizmat, për komitetet konkretisht. Besoj që do të ketë edhe sivjet, sa për t'ju lehtësu pak punën, për t'ju shpjegu për mandatin edhe rolet, edhe çka muni ju me ba.

**z.Bekim Azizi, krzesues i takimit:** Faleminderit shumë. Prandaj neve vetëm na mbetet me zgjedh kryesuesin e komitetit. Kryesuesi i komitetit duhet të jetë nga komuniteti shumicë, në këtë rast nga komuniteti serb. Dhe zv. kryesuesi nga komuniteti shumicë. Andaj unë nuk po humbi kohë, po jau jap fjalën juve që të përcaktoheni për zgjedhjen e kryesuesit.

**znj.Sanja Dejic Vasic:** Propozoj, Nenad Ilican.

**z.Bekim Azizi, kryesues I takimit:** Në rregull. Masi veç është edhe anëtar i komitetit të njëjtë, është pëlqimi i njëjtë për Nenadin. Atëherë kërkoj me ngritje dore: kush është për? Kundër s'ka. Abstenim s'ka. Urime për zgjedhjen. Si edhe për zv. kryesuesin propozohet Visar Demiri. Kush është për? Me zgjedhjen e kryesuesit dhe zv. kryesuesit, komiteti është themelu. Andaj prej sotit, çdo moment edhe ju edhe te Zyra e Kuvendit, për çdo gjë që keni, edhe çështje individualisht edhe çështje grupore, është zyra e hapur edhe për juve, edhe për komunikim me qeverisjen dhe me të gjitha. I keni mundësitë. Faleminderit shumë. Prandaj unë më nuk kam punë këtu me udhëheq. Nenad, urime. Piken "Të ndryshme" mundesh me vazhdu tash ti.

**z.Nenad Ilic:** Së pari do të doja të prezantohem. Unë jam Nenad Ilić nga Binca. Me profesion jam punëtor arsimi në shkollë. Dua t'ju falënderoj të gjithëve për besimin e treguar dhe për emërimin tim si kryesues i Komitetit për Komunitete. Shpresoj që me punën tonë të përbashkët të kontribuojmë në lehtësimin e jetës së të gjitha komuniteteve që jetojnë këtu. Unë jam anëtar i ri i Komitetit për Komunitete dhe njëkohësisht edhe kryesues. Dëgjoj se këtu ka anëtarë që kanë qenë edhe në mandatin e kaluar, prandaj shpresoj që të bashkëpunojmë të gjithë së bashku dhe që ata të më ndihmojnë që ta kryejmë këtë punë ashtu siç duhet. Edhe një herë ju falënderoj për emërimin tim si anëtar i Komitetit dhe si kryesues dhe shpresoj që do të kemi bashkëpunimin më të mirë. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Pika e dytë e rendit të ditës:

1. **Të ndryshme**

**z.Bekim Azizi, kryesues i takimit:** Mund të propozojmë ndonje pike të rendit të ditës, përkatësisht të japim tema për këtë pikë. A ka ndonjëri prej nesh ndonjë temë për të propozuar për të cilën mund të diskutojmë në kuadër të kësaj pike "të ndryshme"?

**znj.Sanja Dejic-Vasic:** Ne në Binçë kemi problem me varrezat, dhe kjo tashmë është një problem prej shumë vitesh. Besoj se tashmë jeni të njohur me këtë çështje. Për ne është vërtet problem edhe të shkojmë atje, pasi varrezat ndodhen lart në kodër dhe nuk ka rrugë. Mendoj se kjo është problemi kryesor për komunitetin tonë.

**z.Zoran Marinkovic:** Kjo çështje ka qenë tashmë edhe në përbërjen e kaluar të Komitetit, si dhe në përbërjen para saj. Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi i atëhershëm i Komitetit për Komunitete, unë dhe prifti ortodoks kemi biseduar tashmë me kryetarin e komunës. Pas kësaj, kryetari ka dërguar një inxhinier në vendin e ngjarjes për të parë se për çfarë bëhet fjalë. Është e mundur që kjo të realizohet gjatë këtij viti.

**z.Bekim Azizi, kryesues i takimit:** Ekzekutimin e bënë zakonisht ekzekutivi, mirëpo çdo kërkesë qe ta bjen në Kuvend për ndarjen e mjeteve, na kemi me realizu.

**z.Zoran Marinkovic:** Do të shihet më vonë nëse kjo do të financohet nga buxheti i komunës apo do të jetë ndonjë donacion. Kjo mund të jetë një pikë e rendit të ditës, por duhet ta shohim në marrëveshje me kryetarin e komunës. Kryesuesi do të ketë të paktën një herë në muaj takim me kryetarin e komunës për të biseduar për të gjitha çështjet. Komiteti për Komunitete jep vetëm rekomandime, do të thotë se nuk jep urdhra. Mund të kërkojë diçka ose të rekomandojë, por nuk është e detyrueshme që ajo që rekomandohet të zbatohet.

**z.Nenad Ilic:** Është mirë që të gjithë jetojmë në mjedise të ndryshme, në fshatra të ndryshme, prandaj secili prej nesh e di më së miri cilat janë problemet në vendin ku jeton. Një nga problemet e mëdha në fshatin Bincë është se fshati ndodhet në një pozicion të tillë që disa njerëz e përdorin atë si rrugë kalimi për transportin e mallrave të ndryshme nga një vend tjetër, nga Maqedonia, dhe kështu rrezikojnë sigurinë e njerëzve që kalojnë në rrugë. Prandaj duhet të shohim nëse ekziston ndonjë mënyrë për të siguruar lëvizje më të lehtë dhe më të sigurt për njerëzit. Natyrisht, duhet të kemi kujdes kur ecim në rrugë, por kjo është me të vërtetë një nga problemet më të mëdha. Shumë herë ka ndodhur që njerëzit të jenë rrezikuar. E di që për vendosjen e policëve të shtrirë nëpër fshat nevojitet leje nga policia ose nga komuna, nuk jam plotësisht i sigurt, por një nga propozimet mund të jetë vendosja e disa policëve të shtrirë. Policia është shpesh në fshat, por nuk është aty 24 orë dhe nuk mund ta sigurojë vazhdimisht rrugën.

**z.Bekim Azizi, kryesues I takimit:** Qeky është qëllimi i komitetit, që jep rekomandime në fund të çdo takimi. Rekomandimet në çdo takim që jepen, tash për pesë pikat që i kemi përmes planit që bëhet thirrja me rend dite, e keni edhe përherë pikën "Të ndryshme", që mundeni, edhe pse s'e keni në rend të ditës, me ngrit çështje të ndryshme. Tash kjo e shqetësimit bëhet një rekomandim edhe për vendosjen e policëve të shtrirë, po bëhet kërkesë edhe te policia që me shtu më shumë qëndrimin edhe përcjelljen. Dmth në fund të çdo takimi nxjerren rekomandimet, ato i dërgohen edhe kryetarit edhe Kuvendit.

**z.Nenad Ilic:** Nëse askush nuk ka diçka tjetër për të shtuar, mund ta mbyllim mbledhjen e komitetit. Ju falënderoj për kontributin tuaj dhe do të shihemi në takimin e ardhshëm.

Mbledhja përfundoj në 10:35 min.

| | |
|---|---|
| **Procesmbajëse:** | **Kryesues i Komitetit për Komunitete** |
| **znj.Antoneta Palja** | **z.Nenad Ilic** |
| ____________ | ____________ |

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA
Pranuar-Primljeno Me-Dana 17-03-2026

| Nr. Fonetar | Numri-Broj | Shtojce-Prilozi | Vlera-Vrednost |
|---|---|---|---|
| 07 | 060 | /07-3 | 44 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Na osnovu clana 53, Zakona br.03-L-040 za Lokalnu Samoupravu (Sluzbeni list Republike Kosova br.28/15, Jun 2008) i clana 44, 45 Statutom Opstine Vitina br.01-013/491, datuma 21.04.2011, predsedavajuci Komiteta za Zajednice donosi sledece:

**P O Z I V**

Pozivate se na ucescu -II- redovne sednice Komiteta za Zajednice, koja ce biti odrzana dana **25.03.2026**. sa pocetkom u **10 casova**.
Sednica ce biti odrzana u konferencijskoj sali Opstine Vitina.

Za predstojecu sednicu predsedavajuci predlaze sledece:

**D n e v n i r e d**

1. **Razmatranje i usvajanje zapisnika sa prve sednice Komiteta za Zajednice.**
2. **Diskusija o postavljanju usporivaca saobracaja ( lezecih policajaca) u selu Binac.**
3. **Pod razno.**

Vitina, 18.03.2026.godine

Predsedavajuci Komiteta za Zajednice
g.Nenad Ilic
N. Ilić

S postovanjem!

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

# ZAPISNIK
## SA PRVE REDOVNE SEDNICE KOMITETA ZA ZAJEDNICE

Održana je I redovna sednica Komiteta za zajednice Opštine Vitina. Sednicu je sazvao i predsedavao predsedavajući Skupštine, g. Bekim Azizi. Sednica je održana u kancelariji predsedavajućeg Skupštine. Sednica je održana **26.02.2026. godine** u **10 časova**. Na sednici su prisustvovali predsedavajući Skupštine, g. Bekim Azizi, g. Nenad Ilić, gđa. Kata Pala, gđa. Sanja Dejic Vasic, g. Rifat Aniqi i gđa. Djellza Fejzullahu. Takođe su učestvovali predstavnica OSCE-a, gđa. Violeta Mehmeti, i službenik za zajednice i povratak, g. Zoran Marinković, dok nisu prisustvovali g. Visar Demiri i g. Elhami Emërllahu.

**g.Bekim Azizi, predsedavajući sastanka:** Hvala vam puno što ste odvojili vreme da se odazovete pozivu za osnivanje Komiteta za zajednice, koji je obavezni komitet koji formira Skupština opštine u Vitini. Ja, za one koji me ne poznaju, sam predsedavajući Skupštine opštine u Vitini. Ja nisam član komiteta, ali sam vas danas pozvao da osnujemo komitet, jer sam odgovoran pred Skupštinom. Ovaj komitet smo u ovom mandatu formirali sa 7 članova. Uključene su zajednice koje žive u opštini Vitina. Od 7 članova, 4 su iz zajednica a 3 su iz većinske zajednice, kako to zakon i propisuje. Pozdravljam i predstavnicu OEBS-a, koja je danas ovde i koja uvek prati sastanke. Takođe pozdravljam i Zorana, koji je iz Kancelarije za zajednice. Fatlum je sekretar Skupštine, koji je stalni deo sastanaka zajednica. On je veza između komiteta i vaših zahteva i preporuka koje dolaze u Skupštinu, one dolaze preko sekretara do nas. Imamo i dva člana iz prethodnog komiteta. Prethodni komitet je imao 5 članova. Oni su se već upoznali i imali su izuzetno dobru saradnju. Verujem da ćete i u ovom mandatu imati dobar mandat, sa dobrim vezama, saradnjom i zalaganjem za interese građana za koje ste i određeni. Ovo je komitet koji svoj rad obavlja uz naknadu. Ako izostanete, nećete biti plaćeni. Kada ste na sednici, dobijate dnevnicu. Dnevnica je oko 200 evra. Jedan sastanak mesečno ste dužni da održite na osnovu zakona. Stoga je dnevni red za ovaj sastanak, na osnovu poziva koji ste dobili:

### Dnevni red

1. **Izbor predsedavajućeg Komiteta za zajednice.**
2. **Pod razno.**

Prva tačka dnevnog reda:

1. **Izbor predsedavajućeg Komiteta za zajednice**

Plan rada smo usvojili u Skupštini, što predstavlja olakšanje za vaš komitet, jer smo ga usvojili još pre Nove godine zajedno sa komitetom koji je ranije bio u funkciji. Usvojili smo plan rada za ovu godinu. Zato, ako želiš Violeta, možeš da ih pozdraviš ili da kažeš nešto.

**gđa.Violeta Mehmeti, OSBE:** Ukratko, OEBS je prisutan i nadgleda i prati mehanizme za učešće zajednica, što podrazumeva Komitet za zajednice, Kancelariju za zajednice i povratak, kao i druge mehanizme. Oni koji su i

ranije bili uključeni znaju da smo mi prisutni, aktivni i da imamo različite aktivnosti. Podržavali smo i nastavićemo da podržavamo rad komiteta, kako u njegovom funkcionisanju, tako i u aktivnostima i saradnji sa drugim opštinama i slično. OEBS se već godinama zalaže da vam obezbedi obuke za mehanizme, konkretno za komitete. Verujem da će ih biti i ove godine, kako bi vam se malo olakšao rad, da vam se objasni mandat, uloge, kao i šta vi možete da uradite u okviru svojih nadležnosti.

**g.Bekim Azizi, predsedavajuči sastanka:** Hvala vam puno. Zato nam preostaje samo da izaberemo predsedavajućeg komiteta. Predsedavajući komiteta treba da bude iz manjinske zajednice, u ovom slučaju iz srpske zajednice. A zamenik predsedavajućeg iz većinske zajednice. Zato neću da gubim vreme, već vam dajem reč da se izjasnite u vezi sa izborom predsedavajućeg.

**gđa.Sanja Dejić Vasić:** Predlažem, Nenad Ilića.

**g.Bekim Azizi, predsedavajući sastanka:** U redu. Pošto je već član istog komiteta, postoji saglasnost za Nenada. Zato tražim glasanje podizanjem ruke, ko je za? Protiv nema, uzdržanih nema. Čestitam na izboru. Takođe, za zamenika predsedavajućeg predlaže se Visar Demiri. Ko je za? Izborom predsedavajućeg i zamenika predsedavajućeg, komitet je osnivan. Zato od danas, u svakom trenutku vi u Kancelariji Skupštine, za sve što imate, bilo pojedinačna pitanja ili grupna pitanja, kancelarija vam je otvorena kako za vas tako i za komunikaciju sa izvršnom vlašću i sa svima ostalima. Imate sve mogućnosti. Hvala vam puno. Ja više nemam obaveza da vodim sednicu. Nenade, čestitam. Tačku "pod razno" možeš sada ti da nastaviš.

**g.Nenad Ilić**: Pre svega bih želeo da se predstavim. Ja sam Nenad Ilić iz Binča. Po zanimanju sam prosvetni radnik u školi. Želim da vam se svima zahvalim na ukazanom poverenju i na mom imenovanju za predsedavajućeg Komiteta za zajednice. Nadam se da ćemo našim zajedničkim radom doprineti olakšavanju života svih zajednica koje ovde žive. Ja sam novi član Komiteta za zajednice, a ujedno i predsedavajući. Čujem da ovde ima članova koji su bili i u prethodnom sazivu, zato se nadam da ćemo svi zajedno sarađivati i da će mi oni pomoći da ovaj posao obavljamo onako kako treba. Još jednom vam se zahvaljujem na imenovanju za člana Komiteta i za predsedavajućeg i nadam se da ćemo imati najbolju moguću saradnju. Prelazimo na sledeću tačku dnevnog reda.

Druga tačka dnevnog reda:

2. **Pod razno**

**g.Bekim Azizi, predsedavajući sastanka:** Možemo predložiti neku tačku dnevnog reda, odnosno izneti teme za ovu tačku. Da li neko od nas ima neku temu da predloži o kojoj bismo mogli da razgovaramo u okviru ove tačke "pod razno"?

**gđa.Sanja Dejić Vasić:** Mi u Binču imamo problem sa grobljem i to je već problem dugi niz godina. Verujem da ste već upoznati sa tim pitanjem. Za nas je zaista problem čak i da odemo tamo, jer se groblje nalazi gore na brdu i ne postoji put. Mislim da je to glavni problem za našu zajednicu.

**g.Zoran Marinković:** Ovo pitanje je već bilo i u prethodnom sastavu Komiteta, kao i u sastavu pre njega. U vezi sa ovom tačkom dnevnog reda, tadašnji predsedavajući Komiteta za zajednice, ja i pravoslavni sveštenik smo već razgovarali sa predsednikom opštine. Nakon toga, predsednik je poslao inženjera na lice mesta da vidi o čemu se radi. Moguće je da će ovo biti realizovano tokom ove godine.

**g.Bekim Azizi, predsedavajući sastanka:** Izvršenje obično sprovodi izvršna vlast, ali svaki zahtev koji dođe u Skupštinu za raspodelu sredstava ćemo realizovati.

**g.Zoran Marinković:** Videće se kasnije da li će ovo biti finansirano iz budžeta opštine ili će biti neka donacija. Ovo može biti tačka dnevnog reda, ali to treba da se vidi u dogovoru sa predsednikom opštine. Predsedavajući će najmanje jednom mesečno imati sastanak sa predsednikom opštine da razgovaraju o svim pitanjima. Komitet za zajednice daje samo preporuke, što znači da ne izdaje naređenja. Može da traži nešto ili da preporuči, ali nije obavezno da ono što se preporuči bude i sprovedeno.

**g.Nenad Ilić:** Dobro je što svi živimo u različitim sredinama, u različitim selima, zato svako od nas najbolje zna koji su problemi na mestu gde živi. Jedan od velikih problema u selu Bincu je to što se selo nalazi na takvoj lokaciji da ga neki ljudi koriste kao put za transport različite robe iz drugih mesta, iz Makedonije, i na taj način ugrožavaju bezbednost ljudi koji prolaze putem. Zato treba da vidimo da li postoji način da se obezbedi lakše i sigurnije kretanje ljudi. Naravno, treba da budemo pažljivi kada hodamo putem, ali ovo je zaista jedan od najvećih problema. Mnogo puta se desilo da su ljudi bili ugroženi. Znam da za postavljanje ležećih policajaca po selu je potrebna dozvola od policije ili opštine, nisam potpuno siguran, ali jedan od predloga može biti postavljanje ležećih policajaca. Policija je često u selu, ali nije tu 24 sata i ne može stalno da obezbeđuje put.

**g.Bekim azizi, predesdavajući sastanka:** Ovo je svrha komiteta, da na kraju svakog sastanka daje preporuke. Preporuke koje se daju na svakom sastanku, sada za pet tačaka koje imamo putem plana i dnevnog reda, uvek uključuju i tačku „Pod razno“, gde možete, iako nije na dnevnom redu, izneti različita pitanja. Sada, ovo pitanje zabrinutosti postaje preporuka, takođe i zahtev prema policiji da se poveća broj prisustava i nadzora, uključujući i postavljanje ležećih policajaca. Dakle, na kraju svakog sastanka se donose preporuke, koje se prosleđuju i predsedniku i Skupštini.

**g.Nenad Ilić:** Ako niko nema ništa više da doda, možemo zatvoriti sastanak komiteta. Hvala vam na vašem doprinosu i vidimo se na sledećem sastanku.

Sastanak je završen u 10:35 časova.

**Zapisničarka:**
**gđa.Antoneta Palja**

______________

**Predsedavajući Komiteta za Zajednice**
**g.Nenad Ilić**

______________